

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“MATERIALE NDERTIMI”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

42214110-3

44171000-9

44334000-0

VLERA E FONDIT LIMIT:

3 392 570(tre milion e treqind e nëntëdhjetë e dy mijë e pesëqind e shtatëdhjetë).

Bazuar në nenin 76 pika 3 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik” e ndryshuar, në zbatim të urdhërit të titullarit, për ngritjen e komisionit për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës sipas specifikimeve teknike për këtë procedurë prokurimi, komisioni bazuar në VKM 285 datë 19.05.2021 neni 76, pika a) manualit të cmimeve të ndertimit 2023 nga portali e Albania) ka bërë përlogaritjen e vlerës limit të kontrates.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta për kualifikim për procedurën, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Në zbatim të nenit 83 të Ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020) është 2% e fondit limit.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklarimit me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve e fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: " Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata ".*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetare, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme."

Sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës Procedurë e hapur të thjeshtuar, edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2 (c) e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitet financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin e fundit (duke përfshirë edhe kështet e maturuara për vitin 2026, duke pasur në vëmendje parashikimet e ligjit 9632, date 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njwsitw e vetqeverisjes vendore), për të gjitha pikat e ushtrimit të veprimtarisë sipas QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024; në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kështeteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti Teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për kontrata të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara

sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nën 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar duke qënë se vlera e fondit limit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.*

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë një deklaratë nëpërmjet së cilës merr përsipër dorëzimin e mallit objekt prokurimi në destinacionin e kërkuar nga AK.

Argumentimi: *Në bazë të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), është përcaktuar ky kriter, me anë të të cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë Autoritetin Kontraktor se marrin përsipër levrimitin e objekt prokurimi sipas kërkesave të Autoriteti Kontraktor.*

Deklarata i shërben AK si një instrument sigurie që minimizon rrezikun e mos levrimit të mallit sipas kërkesave të AK, rrit përgjegjshmërinë e operatorit ekonomik, krijon bazë për monitorim dhe zbatim korrekt të kontratës.

Specifikime Teknike

Specifikimi i Materialeve:

Zgara hekuri

Zgarat duhet të jenë të prodhuara nga çelik strukturor cilësor, të përshtatshme për përdorim në ambiente të jashtme.

- Të kenë kapacitet mbajtës të përshtatshëm për ngarkesa urbane.
- Pa deformime, pa saldime të dobëta dhe pa defekte strukturore.

1. Profile hekuri

Profilet metalike duhet të jenë sipas standardeve për çelik ndërtimi.

- Të jenë profile të tipit L, U, I, katror ose drejtkëndor sipas kërkesës.
- Me seksion dhe trashësi të njëtrajtshme.
- Pa ndryshk të theksuar, pa shtrembërime apo çarje.
- Me përbërje çeliku strukturor (p.sh. S235 ose ekuivalent).

Duhet të jenë të përshtatshme për përpunim dhe montim në kushte kantieri.

2. Tuba (me diametra të ndryshëm)

Tubat duhet të jenë çelik, për përdorim strukturor ose instalime ndihmëse.

- Diametra sipas kërkesave të autoritetit kontraktor
- Trashësi e njëtrajtshme dhe pa defekte.
- Pa korrozion dhe pa dëmtime mekanike.
- Sipërfaqe e trajtuar (e zezë ose e galvanizuar sipas përdorimit).

Prerjet duhet të jenë të pastra dhe të sakta.

3. Pllaka trotuari

Pllakat duhet të jenë element të parafabrikuar betoni ose guri për përdorim në trotuare.

- Rezistencë e lartë ndaj konsumit dhe goditjeve
- Sipërfaqe antirëshqitëse
- Përmasa të rregullta dhe tolerance dimensionale e kufizuar.
- Ngjyrë dhe strukture uniforme.

Duhet të përballojnë trafikun këmbësor dhe ngarkesa të lehta.

4. Traventinat natyror

Travertini duhet të jetë gur natyror i përpunuar në pllaka me përmasa **75 x 40 x 3 cm**, me ngjyre te percaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

- Strukturë kompakte, pa çarje dhe pa defekte
- Trashësi konstante 3 cm
- Rezistencë ndaj konsumit dhe kushteve atmosferike
- Thithje uji e ulët

Sipërfaqja duhet të jetë:

- e përshtatshme për ambiente të jashtme
- antirrëshqitëse
- me uniformitet në ngjyrë

5. Bordura (1 ml, tipe të ndryshme)

Bordurat duhet të jenë element linear të betonit të parafabrikuar ose guri natyror.

- Gjatësia standarde: **1 ml**
- Rezistencë e lartë mekanike dhe ndaj kushteve atmosferike
- Pa çarje, pa thyerje dhe pa defekte prodhimi
- Forma dhe dimensionet sipas standardeve për përdorim urban.

Duhet të jenë të përshtatshme për kufizim trotuari dhe sistemim hapësirash.

Argumentimi I Specifikimeve Teknike:

Specifikimet e përcaktuara për materialet në këtë procedurë prokurimi janë hartuar në përputhje me kërkesat funksionale, qëndrueshmërinë afatgjatë dhe standardet e ndërtimit.

Zgarat prej hekuri janë projektuar për të përballuar ngarkesa të konsiderueshme urbane, përfshirë trafikun dhe kushtet atmosferike.

Kërkesat janë thelbësore për të garantuar sigurinë publike, jetëgjatësinë e produktit dhe rezistencën ndaj konsumimit.

Profilet metalike (L, U, I, katrore, etj.) kërkohen sipas standardeve të çelikut strukturor për të siguruar qëndrueshmëri mekanike, uniformitet në trashësi dhe përmasa dhe mungesë deformimesh apo korrozioni.

Këto specifikime janë të domosdoshme për të garantuar stabilitet strukturor dhe përshtatshmëri gjatë montimit.

Tubat metalike do të përdoren për funksione strukturore dhe ndihmëse.

Specifikimet e përcaktuara sigurojnë rezistencë ndaj kushteve atmosferike, jetëgjatësi dhe funksionim të sigurt në instalime të ndryshme.

Pllakat e betonit ose gurit natyror janë projektuar për përdorim në trotuare dhe zona këmbësorësh. Specifikimet e përcaktuara janë të rëndësishme për të garantuar sigurinë e këmbësorëve, qëndrueshmërinë ndaj trafikut dhe estetikën urbane.

Travertini i përdorur në formë pllakash (p.sh. 75 × 40 × 3 cm) përzgjidhet për rezistencën ndaj kushteve atmosferike, strukturën kompakte pa çarje apo defekte, përthithje të ulët uji.

Këto karakteristika sigurojnë qëndrueshmëri afatgjatë, dhe rezistencë ndaj degradimit.

Bordurat prej betoni ose guri natyror janë elemente të rëndësishme për ndarjen dhe sistemimin e hapësirave urbane.

Specifikimet garantojnë funksionalitet në kufizimin e hapësirave, stabilitet në instalim dhe jetëgjatësi në përdorim.

Të gjitha specifikimet e mësipërme janë të justifikuara teknikisht pasi sigurojnë cilësi të lartë të materialeve, garantojnë siguri dhe qëndrueshmëri në përdorim publik.

Për rrjedhojë, këto kërkesa nuk janë kufizuese, por të domosdoshme.

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës në përzierje të cilëve është përfshirë specialisti i fushës anëtar i njësisë së prokurimit.

Specifikimet teknike, për procedurën objekt prokurimi, shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e mallit dhe lidhen ngushtë me natyrën e kontratës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo specifikim dhe standard të kërkuar.**